

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA	
	KOMUNA E MITROVICËS JUGORE OPSTINA.J MITROVICA/ MUNICIPALITY OF S.MITROVICA/	
	Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca	

NR.PROT	01-052/01-0001543/25
Datë	30.12.2024
PËR/ TO:	z.Bedri HAMZA-Kryetari i Komunës
PËRMES/ CC:	
NGA/ FROM:	z.Bahtir MAXHUNI- Drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjenca
TEMA/ SUBJECT:	Raporti Janar- Dhjetor

Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca në muajin **Janar** 2024 aktivitetin e vet të programuar dhe të planifikuar nga lëmi i Mbrojtjes dhe Shpëtimit e ka realizuar duke u mbështetur në Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera **Nr. 04/L-027** , Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri **Nr. 04/L-012**, Ligjin për Zjarrfikëse dhe Shpëtim **Nr. 04/L-049**, Udhëzimet Administrative, Rregulloren e organizimit të brendshëm të Komunës, Vendimet e Bordit të Drejtorëve si dhe Aktet tjera normative të cilat e rregullojnë këtë materie.

I. Gjatë muajit **Janar** Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca ka hartuar dhe azhurnuar këto plane:

- Raportin e punës vjetore për Drejtorinë për Siguri dhe Emergjenca për vitin 2023;
- Hartimin e plan-programit të punës së Drejtorisë për Siguri dhe Emergjenca për vitin 2024.
- ❖ Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca përveç detyrave të lartë përmendura gjatë muajit **Janar** 2024 ka realizuar edhe këto detyra:
Kemi intervenuar në sanimin - evitimin e rrezikut nga shtylla e ndriqimit në sheshin Isa Boletini e cila ishte dëmtuar dhe paraqiste rrezik për qytetarët.



Kemi kryer pastrimin, zgjerimin dhe thellimin e lumit Lushta nga ura tek lapidarët në drejtim të fshatit Lushta.





Donatori	Kontrata	Punë kryesi	Projektet e realizuara
Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë	Intervenime Emergjente për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi Tjera,	N.T.SH “Ramadani”	Intervenimi për rregullimin e shtratit të lumit Lushta në bazë të kërkesës së banorëve.
Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë	Intervenime Emergjente për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi Tjera,	N.T.SH “Ramadani”	Intervenimi për rregullimin e shtratit të lumit Lushta në bazë të kërkesës së banorëve.
Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë	Intervenime Emergjente për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi Tjera,	N.T.SH “Ramadani”	Është intervenuar në prerjen e shkurreve, gërmimin e dheut në rrugën e fshatit Tërrsten për qasjen e banorëve në varrezat e fshatit.
Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë	Intervenime Emergjente për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi Tjera	N.T.SH “Ramadani”	Kemi intervenuar në rregullimin e shtratit të lumit Lushta
Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë	Intervenime Emergjente për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi Tjera	N.T.SH “Ramadani”	Rrënimi dhe pastrimi i murit mbrojtës tek stadiumi i Trepqës 89 dhe ndërtimin e murit

Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca	Intervenime Emergjente për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi Tjera	N.T.SH “Ramadani”	Furnizim me material ndërtimorë për disa familje që kanë qenë të dëmtuar nga erërat e forta
Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca	Intervenime Emergjente për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi Tjera	N.T.SH “Ramadani”	Intervenim përgjatë rrugës Hekurudha deri tek rruga Fadil Deliqi prerje të shkurreve, hapjes së kanalit përgjatë rrugës etj në bazë të kërkesës së Qendrës Operative 112, Policisë së Kosovës dhe Njësisë Speciale Belvedere.
Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca	Intervenime Emergjente për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi Tjera	N.T.SH “Ramadani”	Intervenim në hapjen e kanalit përgjatë hapsirës e cila është shfrytëzuar për kultivimin e misrit për mbrojtjen nga vërshimet në fshatin Koshtovë
Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca	Intervenime Emergjente për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi Tjera	N.T.SH “Ramadani”	Intervenim për prerjen dhe largimin e shkurreve, hapjes së kanalit dhe vendosjen e gypave të kanalizimit në rrugën e fshatit Kqiç.
Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca	Intervenime Emergjente për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi Tjera	N.T.SH “Ramadani”	Intervenim për rregullimin e hapjes së kanalit dhe vendosjen e gypave të kanalizimit në rrugën e Shipolit.
Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca	Intervenime Emergjente për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi Tjera	N.T.SH “Ramadani”	Funizim me material për rregullimin e urës në fshatin Broboniq në rrugën “Gadaf Behrami”
Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca	Intervenime Emergjente për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi Tjera	N.T.SH “Ramadani”	Furnizimi me material për rregullimin e çatisë e cila është e dëmtuar nga erërat e forta

Gjatë këtij muaji jemi marrë me menaxhimin, monitorimin dhe trajtimin e qenve endacak që bredhin lirshëm në qytetin e Mitrovicës dhe periferi.

Donatori	Projektet e realizuara	Punë kryesi	Periudha
Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë	Menaxhimi, Monitorimi dhe Trajtimi i qenve endacak që bredhin lirshëm në Qytetin e Mitrovicës	A.V “Veterinaria”	Dhjetor 2023- Janar 2024
Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë	Menaxhimi, Monitorimi dhe Trajtimi i qenve endacak që bredhin lirshëm në Qytetin e Mitrovicës	A.V “Veterinaria”	Janar -Shkurt 2024
Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë	Menaxhimi, Monitorimi dhe Trajtimi i qenve endacak që bredhin lirshëm në Qytetin e Mitrovicës	A.V “Veterinaria”	Shkurt -Mars 2024
Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë	Menaxhimi, Monitorimi dhe Trajtimi i qenve endacak që bredhin lirshëm në Qytetin e Mitrovicës	A.V “Veterinaria”	Mars-Prill 2024
Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë	Menaxhimi, Monitorimi dhe Trajtimi i qenve endacak që bredhin lirshëm në Qytetin e Mitrovicës	A.V “Veterinaria”	Prill Maj 2024
Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë	Menaxhimi, Monitorimi dhe Trajtimi i qenve endacak që bredhin lirshëm në Qytetin e Mitrovicës	A.V “Veterinaria”	Maj Qershor 2024
Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë	Menaxhimi, Monitorimi dhe Trajtimi i qenve endacak që bredhin lirshëm në Qytetin e Mitrovicës	A.V “Veterinaria”	Qershor Korrik 2024
Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë	Menaxhimi, Monitorimi dhe Trajtimi i qenve endacak që bredhin lirshëm në Qytetin e Mitrovicës	A.V “Veterinaria”	Korrik -Gusht 2024

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Janar 2024**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 19 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionin e formuar për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet.

➤ Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Shkurt 2024** ka realizuar këto detyra:
Rregullimin e rrugëve lokale dhe pastrimin e mjedisit afër varrezave në fshatin Tërstenë.



Takim pune me ushtrinë e Kosovës FSK ku u diskutuan qështjet e sigurisë në komunë, menaxhimin e emergjencave, bashkpunimin në projektet e skenarëve që lidhen me siguri dhe emergjencave si dhe përforcimin e kapaciteteve civilo- ushtarake.

Jemi marrë me menaxhimin, monitorimin dhe trajtimin e qenve endacak që bredhin lirshëm në qytetin e Mitrovicës dhe periferi.

Duke u bazuar në kërkesën e palës që ka të bëjë me dëmet e shkaktuar nga erërat e forta në lagjen e Shipolit, komisioni me datë 20.02.2024 ka vizituar shtëpinë e tij në Mitrovicë në rrugën “Dëshmorët e Kombit” duke konstatuar dëmet e shkaktuara nga era dhe ka konstatuar se është urgjente intervenimi në këtë shtëpi pasi që përveq kulmit era ka shkaktuar edhe dëme tjera.

Duke u bazuar në kërkesën e palës që ka të bëjë me dëmet e shkaktuara nga lagështia ju është ekspozuar temeli i shtëpisë dhe si pasoj i është dëmtuar laminati dhe dritaret, komisioni me datë 20.02.2024 e ka vizituar shtëpinë e tij në Mitrovicë përkatësisht në fshatin Rashan dhe me këtë rast i ka evidentua këto dëme të shkaktuara nga lagështia .

Gjatë këtij muaji jemi marrë me menaxhimin, monitorimin dhe trajtimin e qenve endacak që bredhin lirshëm në qytetin e Mitrovicës dhe periferi.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Shkurt 2024**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 19 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionin e formuar për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Mars 2024** ka realizuar këto detyra:

Kemi intervenuar në pastrimin e kanalit në lagjen Bair i cili ishte i mbushur nga hudhja e mbeturinave inerte.



Së bashku me Njësinë për Zjarrfikje dhe Shpëtim kemi intervenuar tek ish objekti i Jugobankës për largimin e llamarinës.

Gjatë këtij muaji jemi marrë me menaxhimin, monitorimin dhe trajtimin e qenve endacak që bredhin lirshëm në qytetin e Mitrovicës dhe periferi.

Kemi evituar rrezikun e shembjes – rrëzimin e një pjese të murit në stadiumin e klubit Trepça 89.



Së bashku me zyrtarët e drejtorisë kemi qenë pjesë e punorisë Komunikimi strategjik gjatë implementimit të aktiviteteve të Strategjisë Shtetërore për Parandalimin dhe Luftimin e terrorizmit 2023- 2028” në komunën tonë në kuadër të projektit ‘Resilient Community Program’, financuar nga GCERF, përmes ATRC, implementuar nga BIRN Kosovo.

Kemi dorëzuar kërkesën për iniciimin e procedurave për riparimin komplet të ngrohtores qendrore për objektin e NJPZSH dhe kërkesën për iniciimi të procedurave për blerjen e gomave për kamionat e NJPZSH në zyrën e prokurimit.

Drejtorja për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Mars 2024**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 15 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionin e formuar për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

➤ Drejtorja për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Prill 2024** ka realizuar këto detyra:

Pas daljes në teren të komisionit të formuar nga Kryetari i Komunës të cilët i kanë evidentuar dëmet te disa familje, drejtorja ju ka dalur në ndihmë duke i furnizuar me material ndërtimor.

Gjatë këtij muaji jemi marrë me menaxhimin, monitorimin dhe trajtimin e qenve endacak që bredhin lirshëm në qytetin e Mitrovicës dhe periferi.


Drejtorja për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Prill 2024**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 7 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionin e formuar për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.


Drejtorja për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Maj 2024** ka realizuar këto detyra:

Gjatë këtij muaji kemi nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit me Save the Children Kosova, kjo marrëveshje është bërë me qëllim të realizimit të projektit në shkëmbimin e kapaciteteve që kontribuojnë në avansimin, ndërtimin dhe fuqizimin e kapacitetit të agjencive të nivelit lokal dhe të sektori privat të komunitetit në fushën e parandalimit, mbrojtjes, reagimit dhe rimëkëmbjes nga fatkeqësitë natyrore, teknologjike të shkaktuara nga faktori njeri.

Ky projekt pritet të kontribuoj në edukimin dhe vetëdijësimin e qytetarëve dhe fëmijëve në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe fuqizimit të shoqërisë civile në koordinim të emergjencave dhe integrim me sistemin më të gjerë të menaxhimit të emergjencave.

Pas verifikimit të gjendjes së shtëpive të dy familjeve nga komisioni ju kemi dalur në ndihmë me material ndërtimorë.





Kemi dorëzuar kërkesën në zyrën e prokurimit për inicimin e procedurave për mirëmbajtjen e objektit të Njesisë për Zjarrfikje dhe Shpëtim.

Kemi qenë pjesë e puntorisë nga USAID KMI me temë “ PLANIFIKIMI I BUXHETIT 2025/2027”.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **MAJ 2024**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 10 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionin e formuar për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

➤ Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Qershor 2024** ka realizuar këto detyra:

Kemi qenë pjesë e puntorive ditore nga USAID KMI me temë “ Tenderi ekonomikisht më i favorshëm (TEMF) dhe vlerësimi i tenderëve” dhe në puntorinë “Menaxhimi i projekteve – Faza para tenderimit dhe faza pas tenderimit”.

Kemi dorëzuar kërkesën në zyrën e prokurimit për inicimin e procedurave për mirëmbajtjen e pajisjeve kundër zjarrit në objektet e menaxhuara nga Komuna e Mitrovicës.

Në kuadër të programit të organizuar nga Save the Children për njohurit lidhur me sigurinë individuale, sigurinë kolektive dhe reagimet në rast të fatkeqësive natyrore kemi mbajtur trajnim për vetëdijësimin e nxënësve, mësimmdhënësve dhe prindërve.

Kemi intervenuar për zhbllokimin e rrugës nga dega e shkëputur e një lisi e cila ishte thyer nga erërat e forta gjithashtu kemi intervenuar në rregullimin e shtyllës elektrike në sheshin Isa Boletini.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Qershor 2024**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 11 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionin e formuar për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

❖ Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Korrik 2024** ka realizuar këto detyra:

Kemi mbajtur takim pune me zyrtarët e zyrës së OSBE -së lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin në lagjen 2 Korriku.

Kemi mbajtur takimin me anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi ku është diskutuar gjendja e sigurisë në Komunën e Mitrovicës, siguria në zonat malore-pyjore nga zjarrvënjet dhe të ndryshme.

Takim pune me banorët e fshatit Vinarci të cilët i shpalosën problemet e tyre.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Korrik 2024**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 11 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionin e formuar për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

❖ Gjatë muajit **Gusht** kemi intervenuar në rrënimin e shtëpive të cilat kanë paraqitur rrezik për qytetarët.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Gusht 2024**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 11 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionin e formuar për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

▪ Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Shtator 2024**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 10 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionin e formuar për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

• Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Tetor 2024** ka realizuar këto detyra:

Kemi mbajtur takim pune me ushtruesin e detyrës së Koordinatorit të Qendrës Operative Emergjente Rajonale.

Kemi qenë pjesë e një puntorie online ku është diskutuar eksplorimi i mundësive për identifikimin e kompetencave të nevojshme për shërbyesit civil në përgjigje të strategjisë për qeverisje dhe transformim digjital.

Kemi mbajtur puntori me zyrtarët Raportues të Performancës Komunale “Përmirësimi i mëtejshëm i dokumentimit të të dhënave në Sistemin e Menaxhimit të Performancës.

Kemi dorëzuar kërkesën në zyrën e prokurimit për iniciimin e procedurave të prokurimit për Intervetime Emergjente për Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera të cilësuar si ekstreme nga forcat madhore.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Tetor 2024**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 5 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionin e formuar për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

- ✓ Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit **Nëntor 2024** ka realizuar këto detyra:

Së bashku me stafin e drejtorisë dhe NJPZSH kemi qenë pjesë e seminarit Menaxhimi i mediave sociale dhe komunikimi publik për njësitë e zjarrfikësve dhe shpëtimit.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit **Nëntor 2024**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 2 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionin e formuar për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
- Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit **Dhjetor 2024** ka realizuar këto detyra:

Me kërkesë të Kryetarit të Mitrovicës së Jugut, z. Bedri Hamza, është mbajtur takimi i Komitetit për Menaxhimin e Situatës Emergjente, pas dëmeve të shkaktuara me mjete shpërthyes në kanalin e ujit në fshatin Varagë, Zubin Potok.

Pas situatës së krijuar në Varag të Zubin Potokut ku është dëmtuar kanali i ujit në Ibër Lepenc së bashku me Njësinë për Zjarrfikje dhe Shpëtim kemi shpërndarë ujë në disa lokacione të qytetit të Mitrovicës, respektivisht në qendër të qytetit dhe në rrugën “Ali Zeneli”.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca së bashku me përfaqësuesit tjerë komunal, priten në takim drejtorinë ekzekutiv të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent së bashku me bashkpuntorët e tij.

Në takim është diskutuar për hapat e ndërmarra pas situatës në veri të vendit ku një shpërthim i rëndë shkaktoi dëmtime në kanalin kryesor të ujit në “Ibër Lepenc”.

Kemi pasur takim pune me zyrtarët e Policisë së Kosovës lidhur me situatën e përgjithëshme të sigurisë në Komunën e Mitrovicës.

Kemi pasur takim pune me KFOR-in lidhur me situatën e përgjithëshme të sigurisë në Komunën e Mitrovicës.

Kemi pasur takim pune me zyrtarët e Policisë së Kosovës dhe Drejtorinë e Arsimit lidhur me situatën e përgjithëshme të sigurisë nëpër shkollat e Komunës së Mitrovicës.

Së bashku me zyrtarët e drejtorisë kemi qenë pjesë e puntorisë “**Paralajmërimi i Hershëm dhe Veprimi i Hershëm Kundër Ideologjive Ekstremiste**” ku janë trajtuar temat duke përfshirë konceptet kyçe për paralajmërimin dhe veprimin e hershëm kundër ideologjive ekstremiste, identifikimin dhe kuptimin e shenjave të hershme paralajmëruese të ideologjive ekstremiste dhe ekstremizmit të djathtë, si dhe zhvillimin e qasjeve praktike për adresimin dhe luftimin e ekstremizmit.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit **Dhjetor 2024**, përmes zyrës nr 6 të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 4 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionin e formuar për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.